

**PLENIUMI I IV DHE NDIKIMI I TIJ NË
ARTIN PAMOR TË PIKTORIT EDISON
GJERGO**



Artet pamore

Fjalë kyçe: piktura, partia socialiste, Enver Hoxha, Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, etj.

Ardian Isufi

Universiteti i Arteve-Tiranë. Fakulteti i Arteve të Bukura.

Abstract

Kompozimi në pikturë, si gjinia që pasqyron veprimin e përbashkët të personazheve, mendimin e bashkuar të kolektivit, marrëdhëniet në mes tyre, në vitet '70 kishte arritur rezultate shumë të mira, si në sasi po ashtu edhe në cilësi, në rritjen e nivelit ideoartistik, në pasqyrimin e realitetit tonë socialist, të madhështisë dhe epicitetit të kohës, ku mbizotëronin notat e fuqishme emocionale, zgjidhjet dinamike e koloret e ndritshme, duke bërë të mundur thellimin e përmbajtjes aktuale, përmes përforsimit të karakterit militant, partishmërisë proletare, karakterit kombëtar dhe frymës popullore. Në vitin 1964 është realizuar nga piktori Guri Madhi kompozimet të cilat janë edhe më të kritikuarat të këtij piktori "Pëllëmbë e gjak". Kjo punë artistike e Guri Madhit u kritikua për frymën pesimiste. Piktoret shqiptarë të detyruar për të zbatuar parimet e realizmit socialist, shumica e këtyre piktorëve trajtuan temën e luftës nacional-çlirimtare. Por trajtimi i temave të luftës ishte edhe një mënyrë e tërthortë, për të ikur nga e ashtuquajtura tema e ditës, që kishte të bënte me ndërtimin e realizmit socialist. Qëndrimi besnik i parimeve të realizmit socialist do të thoshte për piktorët të binin në skematizëm të theksuar. Në lidhje me kritikën e artit zyrtar shqiptar, duhet thënë që linte shumë për të dëshiruar, pasi nuk kishte një kastë të përgatitur në këtë fushë, për shkak edhe të mosnjohjes mirë të parimeve të sistemit të kohës, që e cila i jepte mundësi të re artistëve për të futur tek-tuk ndonjë element të artit modernist, por që me kalimin e kohës këto elemente u kapen dhe këta artistë e paguan me gjak dhe me jetë artin e tyre. Rasti tipik është edhe piktori Edison Gjergo, për arrestimin e tij të kompozimit me titull: "Epika e yjeve të mëngjezit", një realizim i tij i vitit 1971, e cila u kritikua nga kritikët e artit zyrtar të kohës për prirje moderniste.

Komunistët me ndjenjën e përgjegjësisë së thellë ndaj partisë, në frymë kritike e autokritike të shëndoshë, dënuan rreptë dëmin e madh që iu shkaktuan partisë me devijimet liberale dhe moderniste që u manifestuan në disa programe të radio-televizionit, sidomos në muzikë e që arritën kulmin në kompleksin e tyre në muzikë, veshje, dekor e tjerë, dhe që i vunë maje me festivalin e 11 të dhjetorit të vitit 1972.

Ata kritikuan rreptë dhe kërkuan sqarime e detaje deri edhe në debatin më të vogël që ndodhi brenda dhe jashtë atij festivali, duke e akuzuar hapur drejtorin e përgjithshëm të Radio-Televizionit Todi Lubonjën, i cili sipas komunisteve duhet të mbaj përgjegjësi kryesore për devijimet liberale dhe oportuniste nga vija e drejtë e partisë, si dhe ndaj drejtoreshës së radios së brendshme Nefo Myftiu, e cila ka gjithashtu përgjegjësi të madhe në këtë devijim të partisë, vijës së saj dhe lejimin e ndikimeve të huaja në një vend që nuk mund të kalonte as një dallëndyshe e huaj, e jo më të kishte tendenca të huaja, në veshje, dekor apo edhe në gjestikulacion të këngëtarëve dhe të prezantuesve të këtij festivali famë keq sipas sistemit, por në historinë e muzikës dhe të kulturës shqiptare do mbetet një gur themeli modernist drejt një rruge që nuk do kishte kthim pas artin, muzikën, pikturën, modën, letërsinë etj.

Mbledhjet, kongreset dhe fjalimet që mbante Enver Hoxha dashje pa dashje shndërroheshin në një shkollë edukimi politik dhe ideologjik për të gjithë, ku nga këto mbledhje duhet të nxirre mësim të rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm politik, të vijës së saj, ideologjik e organizativ të organizatave të partisë, të rinjve, të bashkimeve profesionale, të drejtorisë së

përgjithshme dhe kolegjiueme të radio-televizionit, për të bërë sa më parë kthesën e nevojshme e për ta çuar më përpara gjithë punën e këtij institucioni kaq të rëndësishëm të propagandës së partisë.

“Një rëndësi të veçantë t’i kushtohet orës politike”¹, e cila konsistonte në zhvillimin e formave të diskutimit të lirë, ku kërkohet mendim prej secilit nga studentet. Kjo do të thotë që studenti të ishte i lirë në mendimet e tij? Aspak jo.

Studenti formësohej dhe brumosej që në fillimet e arsimit të tij për t’i shërbyer klasës politike, duke i quajtur se jeni brezi që po u edukon partia dhe keni lindur nën hijen e sistemit të realizmit socialist dhe të nënës parti të punës socialiste.

“Popuj të tërë, apo grupe shoqërore mund të skllavërohen e të shfrytëzohen për një kohë të gjatë, por ata reagojnë në mënyrë përkatëse lidhur me këtë gjendje”.²

Po në Shqipëri në kohën e mbajtjes së Plenumit të 4-të, si u veprua?!!!

“Nën udhëheqjen e Partisë, punonjësit e letërsisë e të arteve të bëjnë atë punë të thellë ideologjike, politike, morale dhe etike që lipset për të luftuar ndikimet dhe helmet e botës së vjetër dhe të asaj kapitaliste e revizioniste aktuale, për të vënë në dukje dhe për të rrënjësuar në karakterin e njerëzve tanë virtytet e larta komuniste”.³

Artistëve dhe shkrimtarëve u kërkoi që të luftonin dhe të luanin në çdo moment të punës së tyre krijuese, rolin e ndihmësit të Partisë, për formimin e njeriut të ri socialist. U kërkoi më këmbëngulje të gjithë punonjësve zyrtarë dhe udhëheqësve të komiteteve të Partisë, që të kuptojnë si duhet rëndësinë e literaturës dhe të arteve. Fjalët që kishte thënë Lenini për rolin e arteve apo edukimin e masave, konsideroheshin si fjalë me shkronja të arta.

“Njeriu është me të vërtetë i lirë, kur respektohen tre kushte: liria intelektuale; liria ekonomike, liria morale”.⁴

Për të folur për plenumin e 4-të dhe ndikimin e tij në artet pamore, duhet të ndalemi te ato personalitete të cilat u ndikuan drejtpërdrejtë nga sistemi, nga plenumi dhe sot përbëjnë një gjurmë të rëndësishme në historinë e arteve pamore.

“Mungesa shpesh herë e një debati parimor për krijimtarinë në përgjithësi dhe për atë të të rinjve në veçanti, përkëdheljet nga disa organe letrare, mungesa e kritikës dhe autokritikës së përhershme si metodë pune, sollën që në disa nga të rinjtë të kultivohej një sedër mikroborgjeze për veten dhe për veprat e tyre; mendjemadhësia e vetëkënaqësia, që janë të huaja për figurën

¹ *Indoktrinimi komunist*, Vëllimi I, vep. e cit., f. 321.

² Erich From, *Shoqëria e shëndoshë*, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2012, f. 22.

³ Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë. Fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të Partisë më 20 dhjetor 1974, lidhur me zbatimin e deritanishëm të detyrave të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë për letërsinë dhe artet”, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 2, Tiranë, 1975, f. 7.

⁴ Erich From, *Shoqëria e shëndoshë*, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2012, f. 313.

morale të krijuesit të letërsisë e të artit të realizmit socialist, e ca më tepër për të riun, që është akoma llastar i njomë dhe i duhet kohë të japë frutet e vërteta të tij. Lidhur me këtë, në raportin e mbajtur nga shoku Enver në plenumin e 4-të të KQ të PPSH, thuhet se të rinjtë krijues letrarë e artistë “ndihmonin jo duke i përkëdhelur, por duke i inkurajuar kur duhet dhe duke i kritikuar kur kjo është e domosdoshme”.⁵

Duke u njohur me dëshmitë e gjalla, me dokumentet arkivore dhe me studimet, që janë bërë në këtë drejtim, na serviret një realitet i hidhur në lidhje me artet pamore dhe me artistët, që ishin përfaqësues të asaj kohe, pikërisht në vitet '60-'70.

Ishte një periudhë e trazuar, ku nuk munguan sjelljet denigruese, persekutimet, internimet dhe dënimet. Plenumi i 4-të, luajti një rol vendimtar për përcaktimin e imazheve të shumë artistëve, shkrimtarëve apo intelektualëve në Shqipëri.

“Në dalldinë krijuese, poeti ose artisti humb sensin e kohës dhe mjedisin ku jeton. Kur del nga kjo gjendje, ai e ka të pamundur të gjykojë se sa shumë kohë ka kaluar”.⁶

Partia dhe udhëheqësi i tij Enver Hoxha, bënte gjithnjë me dije, se duhet kuptuar drejtë në “jetë” dhe në “art”, parimet themelore të metodës së realizimit socialist.

“Marksizëm-leninizmi ishte kundër çdo ideologjie të papajtueshme me të, në artin e realizmit socialist, si në pikturë ashtu edhe në skulpturë”.⁷

Studiuesi dhe imazhisti David Freedberg në studimin e tij për fuqinë e imazhit dhe të teorisë së reagimit emocional, do të shprehej:

“...që të kuptojmë reagimet tona ndaj artit “të lartë” na nevojiten provat e përgjithshme dhe të veçanta që ofrojnë reagimet ndaj imazheve të “ulëta”. Historia e artit përfshihet në historinë e imazheve. Ka pasur dhe ka gjithmonë një vend për historinë e saj se çfarë është dhe çfarë shihet si art. Historia e imazheve ka marrë vendin e saj si disiplinë qendrore në studimin e burrave dhe grave; historia e artit qëndron tanimë disi e përhumbur, si një nënndarje e historisë së kulturave”.⁸

⁵ Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1974, f. 38.

Abaz Hado, *Veshjet popullore dhe elemente të tjerë etnografike në pikturën shqiptare*, botuar në: “Kultura popullore”, nr. 1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturorë dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2011, f. 129. “...në periudhën e socializmit, arti bazohej mbi angazhimin politik dhe tendenciozitetin klasor”.

⁶ Abraham H. Maslow, *Drejt psikologjisë së genies*, Shtëpia Botuese “Plejad”, Tiranë, 2008, f. 134.

⁷ Gëzim Qendro, *Proletariati ynë që rri mbi tokë*, në: “Studime për artin”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturorë dhe Studimeve të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2009, f. 191.

⁸ David Freedberg, *Fuqia e imazheve*, (përktheu Gëzim Qendro), Shtëpia Botuese “Ditura”, Tiranë, 2013, f. 23.

“Klasikët tanë të mëdhenj, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, në veprën e tyre kolosale kanë trajtuar edhe problemet e letërsisë e të arteve”. Shih: Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë. Fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të Partisë më 20 dhjetor 1974, lidhur

Udhëheqësi Enver Hoxha e kishte në rend të parë dhe madje shumë të ashpër luftën ndaj ndikimeve të huaja, sidomos në letërsi dhe arte. Në fjalimet e tij Hoxha bënte gjithmonë një paralelizëm mes funksionit që ka arti borgjezo-revizionist dhe funksionit që kishte arti i realizmit socialist, ku edukimi i masave përbënte edhe objektin e diskutimeve të tij të shumta.

“Temën e luftës e kanë zgjedhur dhe trajtuar me dashuri disa piktorë, të cilët na kanë dhënë, kush më shumë e kush më pak, atmosferën heroike të asaj periudhe të stuhishme dhe të lavdishme të historisë së popullit tonë”⁹, kjo zgjedhje e piktorëve e kishte një shkak. Për të shpëtuar sado pak skemës së realizmit socialist ata “arratiseshin” të temat e mëdha.

Në plenumin e 4-të, Hoxha në lidhje me artin botëror, që sipas tij ishte arti borgjezo-revizionist, do të shprehej kështu:

“Kjo kulturë e veshur me një shkëlqim të jashtëm, e shoqëruar me një reklamë të bujshme, e trajtuar në mënyrën më komerciale dhe që përkrahet e financohet nga borgjezia, vërshon në ekranin e kinemasë e të televizionit, në revista, në gazeta e në radio, në të gjitha mjetet e informacionit e të propagandës masive. Qëllimi i saj është ta kthejë njeriun e thjeshtë në një konsumator pasiv të ideve të helmatisura borgjeze, t’ia bëjë këtë konsum një nevojë e zakon”¹⁰.

Përfaqësuesit kryesorë të arteve pamore të cilët u dënuan gjatë viteve ’70, për shkak të plenumit të katërt ishin:

EDISON GJERGO-(PIKTOR)¹¹

Artisti punon duke vënë në punë mendjen dhe shpirtin. Krijimtaria ka muzë dhe model gjithashtu.

“Edison Gjergo ka propaganduar ndaj artit dekadent modernist dhe e ka ulur artin e Realizmit Socialist”¹²-e gjejmë në akt-akuzën e shkruar për piktorin Gjergo.

Por si mendonte metoda e realizmit socialist?! Sipas metodës së realizmit socialist mbështetja në traditë dhe respektimi i parimeve të soc-realizmit duhet të ishte puna dhe frymëzimi i çdo artisti.

me zbatimin e deritanishëm të detyrave të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë për letërsinë dhe artet”, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 2, Tiranë, 1975, f. 14.

⁹ Kristaq Rama, *Pikurë e ndritshme, e bukur, shqiptare*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. nr. 6, qershor, Tiranë, 1975, f. 83.

¹⁰ Enver Hoxha, *Raportet e fjalimeve, 1972-1973*, f. 321.

¹¹ Edison Gjergo ishte një ndër piktorët më të rëndësishëm shqiptarë, të gjysmës së dytë të shekullit XX. Gjatë analizave të pikturave të tij, shohim se Gjergo kishte prirje dhe tendencë drejt një pikture moderniste, evropiano-perëndimore.

¹² Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.



Piktura: “Epika e yjeve të mëngjesit”

GAT (17.04.2018)

Sipas akademikes Floresha Dado, e cila bën shpjegimin e metodës realiste dhe metodës së realizmit socialist, ajo arrin në këtë përfundim:

*“Sipas teoricienëve socialistë, koncepti i metodës realiste nuk ishte i mjaftueshëm për të pasqyruar realitetin revolucionar. Për këtë arsye krijohet një koncept i ri teorik, metoda e realizmit socialist, e vlerësuar si një ‘metodë e re’, që duhej t’i përgjigjej realitetit të ri socialist”.*¹³

Përgjatë analizave të pikturave të Edison Gjergo-s, ai si karakter artisti, del i vullshëm, shpeshherë i guximshëm dhe në shumë punë të tij, ka ndikuar çasti, momenti.

*“Arti i gjykuar, i kontrolluar nga liderët më të lartë të politikës, të krijon tensione të paparashikueshme”.*¹⁴

Edison Gjergo piktor shqiptar, por me bindje perëndimore, i pabindur ndaj parimeve soc-realiste, të cilat ishin të pranishme edhe në artet pamore.

Piktori Edison Gjergo është shprehur për pikturën e tij, për artin dhe pikturën shqiptare, si dhe për ndikimet që ai vetë pa pasur në lidhje me pikturën perëndimore, duke u shprehur se:

¹³ Floresha Dado, *Cilës ‘metodë’ i përket realizmi socialist*, në: “Letërsi e painterpretuar”, Shtëpia Botuese “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2010, f. 184.

¹⁴ Adriatik Kallulli, *Historia e atdheut në krijimtarinë e një piktori*, në: “Studime për artin”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2009, f. 219.

“... Për pikturën ‘Epika e yjeve të mëngjesit’ që më kritikoi me të drejtë Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve, më lavdëruan edhe shokët e mi. Maks Velo më tha se jam një njeri me talent dhe se në këtë pikturë unë kisha përdorur talent e mjeshtëri... Unë kisha lexuar disa revista dhe libra të huaj në bibliotekën e institutit, si dhe citate të artistëve dekadentë mbi ‘lirinë e pakufishme’ të krijimtarisë dhe këto pikëpamje të tyre i kam komentuar duke biseduar me Maks Velon, emrat e tyre tani nuk më kujtohen, duke i lavdëruar ata për mendimet, krijimet dhe pikturat e tyre”.¹⁵

Në akt-akuzën për piktorin Edison Gjergo, shkruhet se:

“Veprimtaria e kryer nga ky i pandehur, paraqes rrezikshmëri të theksuar shoqërore, për faktin se ka synuar në minimum dhe dobësimin e pushtetit popullor.

Veprimtaria armiqësore e të pandehurit Edison Gjergo, provohet me pohimet e tij të bëra në hetuesi, me tabllotë, portetet dhe skicat e gjetura në studion e tij, me akt ekspertimin, si dhe me deklaratimet e dëshmitarëve”.¹⁶

Këto parime kishin të bënin jo vetëm me respektimin e tyre, por edhe me ngulitjen në trurin dhe në krijimtarinë e secilit prej artistëve, duke filluar me:

- Forcimin e vijës së Partisë;
- Mbizotërimi i optimizmit, përmes ngjyrave, motiveve, tematikës dhe gjestit;
- Mos shfaqja e tendencave dhe fenomeneve të ndikimeve të huaja apo “shfaqje të huaja antisocialiste”¹⁷;
- Kristalizimi i kultit të Enver Hoxhës apo “lufta e tij titanike”¹⁸ në përjetësimin e kultit të tij.
- Figura e heroit pozitiv;
- Mbështetja në motive popullore tradicionale;
- Ndërtimi i njeriu të Ri Socialist;
- Rritja e vigjilencës artistike;
- Kulti i Partisë, i punëtorit, i kooperativistit, i dëshmorit, i gruas socialiste etj;
- Komunikimi drejtpërdrejt i artistit me masën dhe edukimi estetik socialist i tyre.

¹⁵ Maks Velo, *Jetë paralele (Sipas raporteve të Sigurimit të Shtetit)-Dokumentet sekrete të ndjekjes, hetimit, dënimit dhe burgut*, UET/PRESS, Tiranë, 2018, f. 20.

¹⁶ Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.

¹⁷ **Shfaqje të huaja antisocialiste**: veprime, sjellje ose qëndrime që binin në kundërshtim me parimet komuniste, të cilësuar nga regjimi i kohës dhe që në vendin tonë, konsideroheshin si ndikime të botës kapitaliste e revizioniste.

¹⁸ M.J.Alex. Standish, *Roli i Enver Hoxhës në zhvillimin e miteve socialiste shqiptare*, në: “Roli i miteve në historinë e Shqipërisë”, botuar në revistën: “Përpjekja”, Viti VI, nr. 15-16, janar-dhjetor, Tiranë, 1999, f. 60.

*“Edison Gjergo përfaqëson artistët e talentuar shqiptarë të viteve '60-'70 të shekullit të kaluar, të cilët u keqtrajtuan dhe u dënuan për shkak se në krijimtarinë e tyre artistike devijuan nga kallëpi ideologjike. Vendimet famëkeqe të plenumit IV të Komitetit Qendror të PPSH-së përndoqën artistët tanë e masakruan përfundimisht artin e kulturën shqiptare, duke e futur në skemën socrealiste”.*¹⁹

Edison Gjergo - piktori shqiptar, që i përkiste gjysmës së dytë të shekullit XX. Me shije nga arti perëndimor, modern, u qëndroi larg këtyre parimeve dhe rregullave të instaluara në Shqipërinë Socialiste, ku edhe ai jetonte. Në vitet '70 piktori Edison Gjergo mund të cilësohet si një erë e fortë ndryshimi për artet pamore, ku tablotë e tij dalloheshin për *“modernizmin”*²⁰ që përcillnin.

Mos përputhja me realitetin tonë socialist dhe parimet e soc-realizimit, për piktorin Edison Gjergo, i cili u kritikua për tablonë *“Këngë aksionesh”*, për qëndrimin formalist dhe për zërin e trishtuar të vajzave, që e cila ishte në kundërshtim me parimet e realizimit socialist, pasi optimizmi duhet të mbizotëronte kudo.

*“Realiteti ynë socialist në këto shkrime është shtrembëruar, është errësuar, lufta dhe perspektiva është vënë në dyshim ose është dhënë në mënyrë të dyshimtë. Po kështu tek tabloja “Këngë aksionesh” të Edison Gjergos, me qëndrimin formalist që i mban autori, krijohet një pasqyrim i shtrembëruar i jetës. kënga e vajzave tingëllon e trishtuar, gjë që nuk përputhet me realitetin e aksioneve dhe figurën optimiste të rinisë sonë”.*²¹

Piktori Gjergo në vitet 1971-1973, ku ishte edhe në kulmin e karrierës së tij si artist snob dhe modern, u dallua si *“piktori fenomen”* dhe pikturat e tij, kishin prirje dukshëm kah rrymave dhe ndikimi evropian perëndimor. Në veprat e Gjergos ndihej *“era e kubizmit”* dhe *“ekspresionizmit”*²² evropian, duke i qëndruar apo më mirë të themi duke i *“thyer”* me dashje

¹⁹ Lili Sula, *Fiksioni vs faktit në veprën Epika e yjeve të mëngjesit, të Rudi Erebarës*, botuar në: *“Seminari XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2017, f. 116.

²⁰ Shih Sabri Hamiti, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta LXXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 28, Prishtinë, 2005, f. 156. *“Sëmundja apo sprova më e madhe e modernitetit është përsosja e teknikës së manipulimit, aq më tepër kur ajo merr trajtën e retorikës së shpëtimit, teknika e shpëtimit të individit duke ia marrë atij cilësitë, vetitë, identiteti”.*

²¹ Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën: *“Nëntori”*, nr. 1, Tiranë, 1974, f. 34.

²² *“Termi vetë mund të mos jetë dhe aq i gjetur, ngaqë dihet se të gjithë shprehin vetveten në gjithçka që bëjnë apo që lenë pa bërë, por kjo fjalë u bë një emërtim i volitshëm për shkak të atij kontrasti me impresionizmin që e bën të mbahet mend lehtë dhe si emërtim ka dalë i dobishëm. Ajo që e ngacmoi publikun në artin ekspresionist ishte, ndoshta, jo aq fakti që natyra paraqitej e shtrembëruar, por se rezultati i saj na largonte nga bukuria. Van Gogh-u kishte të drejtë kur thoshte se, metoda e zgjedhur prej tij mund të krahasohej me atë të karikaturistit. Karikatura kishte qenë gjithmonë “ekspresioniste” sepse karikaturisti luan me shëmbëllimin e viktimës së vet dhe e shtrembëron për të shprehur çka ndjen për atë bashkëqytetar. Sa kohë që këto shtrembërime të natyrës lundronin nën flamurin e humorit, dukej se askush nuk haste ndonjë vështirësi për t'i kuptuar. Arti humoristik ishte një fushë ku lejohej gjithçka sepse ndaj tij njerëzit nuk kishin ato paragjykimet që ruanin Artin me A të madhe”.* Shih: E. H. Gombrich, *Historia e Artit*, botuar nga fondacioni për *“Një Shoqëri të Hapur në Shqipëri”*, Tiranë, 1996, f. 564.

rregullat e ngurta akademike. Ai doli jashtë skemës së përcaktuar, skemë e cila ishte bërë pjesë e kulturës shqiptare, e në mënyrë të veçantë kishte arritur të depërtonte edhe në artin figurativ shqiptar.

*“Idetë ndikojnë në sjelljet vetëm atëherë kur shndërrohen në ndjenja. Atëherë ato marrin pjesë në formimin e karakterit”.*²³

Vitet '70, ishin vitet të cilat u duk sikur erdhi një erë e lehtë liberalizmi, kudo në kulturën shqiptare, ndikoi edhe në tharmin e krijuesve të piktorëve. Edison Gjergo ishte në grupin e atyre artistëve të cilët konsideroheshin si “të rinj” dhe kishin prirje, drejt së resë apo drejt “novatores”, term i njohur për kohën.

Tabloja e tij “Epika e yjeve të mëngjesit” u bë shkak i rrënimit të jetës së piktorit. Kjo pikturë ka si subjekt luftën nacionalçlirimtare.

*“Piktorët e skulptorët tanë, në figurat e heronjve të kohës, na kanë dhënë botën e tyre të brendshme dhe gjithë larminë e dinamizmin e jetës sonë socialiste, atmosferën revolucionare, entuziaste që na rrethon. Në veprat më të arrira të kësaj ekspozite vërehet përpjekja e autorëve për të pasqyruar në portrete figura të goditura artistike, që mishërojnë ide të rëndësishme aktuale dhe militante. Në to piktorët kanë synuar të krijojnë portrete jetësore të heronjve të ditëve tona, të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare ose të periudhave të kaluara historike. Ata janë përpjekur të zbulojnë që është më thelbësore dhe më tipike, t'i kthejnë portretet në figura artistike që të emocionojnë dhe të frymëzojnë me thjeshtësinë e zgjidhjes dhe qartësinë e mendimit, t'i bëjnë ato më komunikuese me masat”.*²⁴

Kjo tablo e Gjergos paraqiste një çast pushimi, të një formacioni partizan, të cilët ishin të ndarë në dy grupe. Në grupin e parë, një grup partizanësh janë mbledhur pranë një malësori nga zona veriore e Shqipërisë, ku po këndohet me një lahutë. Si figurë kryesore në këtë tablo mbizotëron lahutari plak, i cili po këndon këngët epike shqiptare. Një skenë e përfytyruar nga piktori si natë me yje, duke ia shtuar tablosë notat epiko-romantike.

“Kodet e leximit të një vepre pamore përmbajnë edhe parimet rregulluese gestaltiste të perceptimit si marrëdhënien figurë-sfond; parimin e afërsisë, barazisë dhe ngjashmërisë, formën e hapur formën e mbyllur, përvojën perceptuese, ekonominë pamore, dhe Pragnaz-in. Rregullat e lidhura me ritmin, vektorialitetin, lëvizjen, drejtimin dhe simetrinë”.²⁵

Në anën e djathtë të kësaj tabloje të Gjergos, ndodhet një vajze partizane, e cila mban në dorë një lule me petale të kuqe. Duket nga kjo tablo që kemi me dy skena, ku në njërin vëmendja është te kënga e cila këndon lahutari²⁶ plak dhe të tjera kjo vajzë e re, e cila e shkëputur nga skena

²³ Gustav Le Bon, *Psikologjia e popujve dhe e turmave*, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2012, f. 95.

²⁴ Fatmir Haxhiu, *Portreti në pikturë, në ekspozitën kombëtare të arteve figurative*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 7, Tiranë, 1975, f. 126.

²⁵ Gëzim Qendro, *Gjuha Pamore*, Universiteti Polis, Botime Afrojdit, Tiranë, 2008, f. xix.

²⁶ Shih: Martin Camaj, *Njeriu me vete e më tjerë*, Shtëpia Botuese “Onufri”, Tiranë, 2012, vargjet: “Lahuta mbet varë n' tra, Mixha kalbët n'dhé, E, nipat s'dinë me i ra”.

e parë shijon freskinë e lules, që mban në dorë. Nëse do analizonim këtë tablo sot, në kontekst të zhvillimeve të asaj kohe dhe zbatimit të parimeve soc-realiste, mund të themi se tabloja, ka një skenë me dy qëndrime: ku në njërin pamje kemi lidhjen dhe vijimësinë e jetës.

Lidhja = plakun + vijimësia e jetës = vajzën e re.

Në këtë rast plaku simbolizon të vjetrën, tejçimin e traditës, trashëgiminë ndër vite, mençurinë dhe origjinën, kurse vajza përfaqëson të renë, energjinë, erodin, dashurinë, pasionin.

Veshjet e personazheve në pikturë me pallto ushtarake tipike të kohës, të gjera dhe të gjata të cilat përdorshin në kohën e dimrit, ose të njohura ndryshe si kapota ushtrie, tregon se stina në të cilën ndodhen është stina e dimrit. Por sipas parimeve të realizmit socialist në mendjet dhe zemrat e artistëve nuk duhet të demonstrohej kjo stinë, e aq më tepër të bëhej publike përmes artit figurativ.

Ngjyrat e ftohta dhe ato të akullta nuk duhet të ishin pjesë e krijimtarisë artistike të piktorëve, pasi ato përcjellin errësirën, pesimizmin dhe mos lumturinë. Ngjyrat e ftohta ishin tendencë kah kubizmi.

“Dihet se piktorët e të gjitha periudhave janë munduar të parashtronjë zgjidhjen e tyre për atë paradoks thelbësor të pikturës, që është pasqyrimi i thellësisë në një sipërfaqe. Kubizmi nuk ishte orvatje për ta sheshuar e për ta fshirë këtë paradoks, por më fort për ta shfrytëzuar për efekte të reja”.²⁷

Një pikturë e realizimit socialist nuk duhet të njihte dritë-hijen, pasi hija ishte e ndaluar të shfaqet edhe gjatë ecjes së individit, pasi ajo paraqiste dyzimin e personalitetit, e aq më tepër të ishte pjesë e artit pamor shqiptar. Kjo tablo, e cila kishte hije dhe dritë, ose siç njihet në gjuhën e artit pamor dritëhije si dhe portretet e personazheve, që ishin me prirje grafike, duke i dhënë kështu doza të forta të artit modern evropian-perëndimor, nuk mund të realizoheshin brenda Shqipërisë soc-realiste. Kjo vepër e Gjergos, është cilësuar nga kritika e artit shqiptar, si një vepër tepër e veçantë, me tone të larta moderniteti dhe unike, për artin shqiptar shekullit XX.

Sot në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, ruhen një koleksion i vetëm prej katër tablosh të piktorit Edison Gjergos, të tilla, si: “Heroina Zonja Çurre” (1966), “Epika e yjeve të mëngjesit” (1971), “Fonditori”(1971) dhe “Portret malësoreje” (1972). Vetëm pas vitit 1990, veprat e piktorit Edison Gjergo u bënë pjesë e linjës muzeale të GKA.

Ajo çfarë vlen të përmendet në lidhje me këtë piktor, është edhe fakti se për herë të parë, me rastin e çeljes së Muzeut më të ri Kombëtar të quajtur si: “Muzeu Kombëtar i Përgjimeve”- “Shtëpia me gjethe” i hapur me 23 Maj 2017. Shtëpi e cila ka brenda saj 31 dhoma, 31 dhoma të mbushura plot me krime të komunizmit.

²⁷ E. H. Gombrich, *Historia e Artit*, botuar nga fondacioni për “Një Shoqëri të Hapur në Shqipëri”, Tiranë, 1996, f. 575-576.

“Shtëpia me gjethe” një aset njohje dhe objekt studimi për krimet e komunizmit, ku u bë e njohur edhe dosja e burgimit të piktorit Edison Gjergo.

Ky muze, i cili përbëhet prej 31 dhomash dhe ku ruan të gjalla historitë më ç’ njerëzore të persekutimeve të intelektualëve shqiptarë, artistëve dhe personave, të cilët tentuan të shohin një “Shqipëri tjetër”, një Shqipëri të lirë, ku ëndërronin një Shqipëri drejt Evropës së lirë, një Shqipëri pa tela me gjemba. Këta artistë dhe shkrimtarë u denigruan, përmes sigurimit të shtetit, spiunazhit, të rrethuar në dhoma të veçanta izolimi, pse ata mendonin ndryshe.

Të pasurit një dhomë për të parë dhe gjurmuar dokumentet e përgjimeve dhe të burgosjes së Gjergos, mund të themi se kjo dhomë përbën një institucion të kujtesës kombëtare, që gjurmët e vuajtjes së tij, të mos mbulohen nga pluhuri i historisë së kohëve të brezave të ardhshëm, por të dalin në dritë dhe të jetojnë për të dëshmuar.

Studiuesi Sabri Hamiti në lidhje me zberthimin e identitetit të nëpërkëmbur do të shprehej kështu:

*“Kur të bien të gjitha metodat e mbrojtjes, atëherë mbetet vetëm mbrojtja nëpërmjet kujtesës dhe kulturës”.*²⁸, ideja se qëndresa e kulturës është më e fuqishme se sa qendra fizike, kjo duket në “veprën dëshmi”, që Edison Gjergo i la trashëgimi artit shqiptar në përgjithësi dhe arteve pamore në veçanti.

Përgjatë gjithë sinkretizmit të kësaj jetë, zënë një vend të konsiderueshëm jo vetëm dokumentet arkivore, por edhe arkivi i gjallë, kujtesa e ruajtjes kombëtare nga vetë familjarët dhe njohësit e artit apo punës së shkrimtarëve dhe artistëve. Një vend të rëndësishëm në këtë studim zë edhe dëshmia e ish-të fejuarës së Edison Gjergos, e cila me shumë insistim nga ana jonë arritëm t’i merrnin këtë dëshmi të saj, për piktorin Gjergo. Ku ndër të tjera Shpresa Leka do shprehej:

*“Tabloja që e bëri të pavdekshëm Edisonin ishte “Epika e yjeve të mëngjesit”. Në kohën kur e arrestuan Edisonin, shumë piktura të tij u sekuestruan nga sigurimi. Në këto piktura të sekuestruara ishte edhe një tablo me figurën time, ndoshta nga më të bukurat. Jam përprjekur ta gjej, por kushedi se ku ka përfunduar, tek koleksionistët trafikantë”.*²⁹

Kurse një tjetër njohës i veprës së Edison Gjergos, aktivist dhe piktor në vitet ’70, në një intervistë së fundi është shprehur se:

“Në ato vite që u burgosin qarkullonin zëra se i kanë gjetur piktura në shtëpi, të cilat nuk u takonin rrymës, pra rrymës që ishte në atë kohë, rrymës së soc-realizmit. Edisoni pas plenumit të 4-të, u dënua për tablonë “Epika e yjeve të mëngjesit”. Tablo e cila u konsiderua nga komisioni i akt-ekspertizës, si një tablo së cilës i mungonin ngjyrat e jetës dhe kishte ngjyra nate, ngjyra të

²⁸ Sabri Hamiti, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta LXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 28, Prishtinë, 2005, f. 157.

²⁹ Intervistë me Shpresa Leka-ish të fejuarën e piktorit Edison Gjergo, e cila di detaje, momente dhe të fshehta të cilat, një ditë mund të shkruajë në librin e saj të jetës. (17.07.2017).

*cilat për kohën, konsideroheshin si ngjyra pesimiste. Tabloja e Edisonit u paraqit në një ekspozitë kombëtare, vetë Edisoni ishte prej natyre shumë ekspresiv”.*³⁰

Një dhomë në këtë muze është në funksion të gjithë përgjimeve dhe të dënimit të Edison Gjergos, ku ajo çfarë të bie më shumë në sy, janë edhe pseudonimet paradoksale dhe të çuditshme, duke filluar nga “Artisti”, e duke përfunduar te “Gjethja e mollës”.

Nëse do bënim një analizë të pseudonimeve të përdorura në dosjen e burgimit të piktorit Gjergo, mund të themi se pseudonimi “Artisti” fare mirë, mund ta quajmë një institucion të pa dekretuar, por tepër funksional, i cili ndiqte një mekanizëm të mirëorganizuar të shpëlarjes së trurit, duke përdorur nga karrikat elektrike apo një vezët e ziera poshtë sjetullave, e duke mbërritur të pseudonimi tjetër “Plani”, për të na treguar se çdo gjë ishte një skema e mirëmenduar dhe e mirëmenaxhuar nga Partia – shtet, duke të bërë të detyruar të tregosh edhe sa herë ke thithur nga gjiri i nënës, e duke të detyruar të pranosh mendime apo vepra, të cilat nuk të kishte shkuar asnjëherë mendja, deri sa “Plani” të finalizonte të gjitha pikat mbi i. Pseudonimi “Bufeja e madhe”, ishte vendi ku të ftonin si mik në kafe dhe të zbërthenin edhe ëndrrat që nuk i kishte parë, “Dëshira”, ishte një tjetër pseudonim, pasi vetëm duke t’i ditur dëshirat, ata arrinin t’i vrisnin dhe t’i gruposnin ato sikur të mos kishin ekzistuar asnjëherë, por duke të lënë të gjallë, për të shijuar ndjenjën më të dhimbshme, të asaj, që të tjerët ta kishin gatuar jo për fajin tënd.

“Mekaniku” ishte një tjetër pseudonim i zbërthimit të ideve dhe mendimeve të artistëve, i cili të bën të mendosh, sa të drejtë ka pas Ismail Kadare, kur ka shkruar romanin e tij, “Pallati i ëndrrave”. “Fatmiri”, ishte përcaktimi i një “fati të mirë” për çdo artist, ose duke ia ndaluar veprën e tij, ose duke e përgjuar, apo më e keqja fare duke e dënuar dhe ekzekutuar me jetë.

Pseudonimi “Gjethja e mollës”, ishte ai pseudonim, ku në shumë raste regjimi hoxhian, të vriste natën e të qante ditën, duke të torturuar apo më pas asgjësuar, në vendin më të paimagjinueshëm. E ku sipër varrit të mbillnin një fidan, duke pritur që të lulëzojë, për të humbur kështu gjurmët e ekzistencës njerëzore dhe artistike.

Në shumë raste artistët ishin të gjallë, por inekzistent, do ta quante vetën edhe piktori Edison Gjergo, nëse do ta kishim pyetur pasi doli nga burgu dhe që iu ndalua të ushtronte profesionin e tij të piktorit.

Edison Gjergo e ndoqi një fat tragjik, për të krijuar art, por ai la art, ai e ka lënë të dëshmuar emrin dhe gjurmët e tij, në Historinë e Arteve Figurative Shqiptare.

Për piktorin Gjergo mund të themi se ishte artisti shqiptar, i cili hapi portat e perëndimit. Ai përmes artit të tij në Shqipëri, solli një ide, konceptim, lëvizje, gjest, stil, formë dhe përmbajtje, por mbi të gjitha solli shijen evropiane, duke e larë me gjakun dhe jetën e tij, këtë evoluim në artin pamor. Arti dhe imazhi i Edison Gjergos, u dhunua, u vra dhe u tjetërsua.

³⁰ Pjetër Marku-Piktor (06.07.2019). Shih: Islam Spahia, “Karuseli i totalitarizmit” - shënime mbi kujtesën dhe kulturën, ku autori si një i dënuar politik, pasqyron portretet, vuajtjet dhe përsiatjet e disa prej të burgosurve që ishte së bashku me ta, e një vend të veçantë në këtë libër zë edhe piktori Edison Gjergo.

Në një intervistë me një ndër poetet që krijuan dhe jetuan në vitet '70, i njohur edhe për idetë e tij novatore, ishte edhe Rudolf Marku, i cili për personalitetet bashkëkohës të tij, do të shprehet:

*“Ali Oseku, Edison Gjergo dhe Maks Velo, janë tre piktorë që u arrestuan dhe u dërguan në burgun e Spaçit.. Shkrimtari Ismail Kadare u vu shumë shpejt në shënjestër për botimin e romanit “Dimri i vetmisë së madhe”. Shkrimtarë të tjerë nxituan të botojnë vepra skematike dhe partiake, me qëllim që të ruanin privilegjet dhe vendet e punës...”*³¹

Histeria vigjilente u duk, sikur po zbutej paska andej nga viti 1978, por natyrisht jo lufta kundër gabimeve ideologjike dhe devijimeve nga vija e partisë.

*“Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror kritikoi rreptë disa shfaqje të dëmshme, që kishin të bënin me imtime të së huajës reaksionare, me trajtimin e shtrembër të kontradiktave të shoqërisë sonë, me teorizime që përçmonin krijimtarinë popullore etj. Ai shtroi detyra të rëndësishme përpara gjithë frontit të kulturës. Zbatimi i tyre dha një hov të ri zhvillimit të letërsisë dhe arteve, tërë veprimtarisë kulturore e artistike. Përparime të mëdha janë bërë në të gjitha fushat, në letërsi e në muzikë, në kinematografi e në teatër, në pikturë e në skulpturë, në opera e në balet”*³²

Studiuesi dhe poeti Sadik Bejko në studimin e tij: “Disidentët e rremë”, do të shprehet, për artistët dhe piktorët të cilët u dënuan me burg në vitet '70.

*“Me burg u ndëshkuan piktori Ali Oseku (l. 1944), arkitekti dhe piktori M. Velo (1935). Piktori i talentuar E. Gjergo (1938-88) pas burgut vdiq në depresion dhe i alkolizuar”*³³

Por edhe studiuesi anglez Robert Elsie do shprehet, në lidhje me piktorët të cilët u dënuan, për shkak të Plenumit të 4-të, ku shprehet se:

*“Piktorë si Maks Velo (l. 1935), Edison Gjergo (l. 1938), dhe Ali Oseku (l. 1944) 'u demaskuan' në Plenumin e 4-t dhe u dërguan në burgje apo në kampe përqëndrimi të tillë, si miniera famëkeqe e bakrit në Spaç, për agjitacion e propagandë - domethënë, pse kishin shprehur një farë interesimi për Pablo Pikason, Salvador Dalinë, apo Maks Ernstin”*³⁴

³¹ Interviste me Rudolf Markun-Shkrimtar. (09.03.2018).

³² Enver Hoxha, *Për rininë*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1985, f. 440.

³³ Shih: Sadik Bejko, *Përndjekja në letërsi dhe në arte gjatë komunizmit*, në: “Disidentët e rremë”, vep. e cit.

³⁴ Robert Elsie, *Një fund dhe një fillim – (Vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare bashkëkohore)*, botuar nga Shtëpia Botuese “Globus R”, Tiranë, 1995 & Shtëpia Botuese “Buzuku”, Prishtinë, 1995, f. 109.

Si përfundim

Dosja e Edison Gjergos sot është e hapur për publikun e gjerë në Muzeun e Gjetheve në Tiranë, në të cilët shënohet ky mbishkrim për të: “Edison Gjergo (1939-1989) ka qenë piktor i njohur, i cili u arrestua në 15 janar të vitit 1975 me akuzën: “Agjetacion dhe Propagandë kundër pushtetit popullor”. Edisoni u dënua nga gjykata e Tiranës me 8 vite burg, të cilat i vuajti në kampin e Spaçit, bashkë me piktorin Ali Oseku dhe Maks Velon. E njohur si pranvera e liberalizmit e viteve '70, por që nuk pati jetëgjatësi. Piktori Edison Gjergo numëron dy ekspozita kombëtare të titulluar “Pranvera” (1971, 1972), të cilat u ndaluan menjëherë nga Partia-shtet, duke ndaluar dhe dënuar, çdo lloj tendence të quajtur “novatore” prej sistemit komunist, si në letërsi, art dhe kulturë, të konsideruara si fenomene me tendenca të ndikimit të huaj, e si të tilla quheshin veprime antikombëtare dhe antiligjore.

Edison Gjergo, u akuzua dhe u dënua për veprën e tij të fundit të ekspozuar, “Epika e yjeve të mëngjesit” (1971). Kjo pikturë e cila ishte edhe fundi i personalitetit, imazhit dhe jetës së autorit, por që ka shenja të qartë të ideve dhe të konceptimeve për një pikturë ndryshe, për një pikturë bashkëkohore shqiptare.

Krijimtaria e Edison Gjergos. u cilësua nga Partia-shtet, si art i degjeneruar dhe me ndikime të thella “borgjezo-revizioniste”. Vitet 1973-1974, vite të cilat përkuan edhe me ngjarje dhe furtuna politike, lapsi kapi edhe krijimtarinë dhe si rrjedhojë edhe jetën e Edison Gjergos.

Piktori Gjergo u dënua me 8 vjet burg si pasojë e Plenumit të 4-të, nga vitet 1974-1982 nga Gjykata, me akuzën: “Për largim nga parimet e sistemit socialist dhe për ndikimet e tij nga idetë e huaja, nga idetë liberale”, të ndaluar aso kohe në Shqipërinë Popullore Socialiste.

I cilësuar si artist me ndikime të thella nga piktura evropiane dhe perëndimore, ia ndalua krijimtaria në mënyrë kategorike brenda territorit shqiptar edhe pas daljes së tij nga burgju. Pasi doli nga burgju piktori dhe artisti Edison Gjergo punoi si një punëtor i thjeshtë, ku nuk iu lejua që të ekspozojë më kurrë artin e tij. Ai ndërroi jetë i sëmurë dhe mbi të gjitha i braktisur nga familjaret dhe miqtë.

Bibliografia

- Dado, Floresha, *Cilës 'metodë' i përket realizmi socialist*, në: “Letërsi e painterpretuar”, Shtëpia Botuese “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2010.
- Elsie, Robert, *Një fund dhe një fillim - (Vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare bashkëkohore)*, botuar nga Shtëpia Botuese “Globus R”, Tiranë, 1995 & Shtëpia Botuese “Buzuku”, Prishtinë, 1995.
- Freedberg, David, *Fuqia e imazheve*, (përktheu Gëzim Qendro), Shtëpia Botuese “Ditura”, Tiranë, 2013.
- From, Erich, *Shoqëria e shëndoshë*, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2012.
- Gombrich, E. H, *Historia e Artit*, botuar nga fondacioni për “Një Shoqëri të Hapur në Shqipëri”, Tiranë, 1996.

- Gjergo, Edison, Dosja e hetuesisë/Ministria e Brendshme, nr. 10667/1-A, “Për të pandehurin Edison Gjergo”, Akuza: “Agjitacion dhe Propagandë”, Në bazë të nenit 73/I, Data e fillimit 13 janar 1975, Data e mbarimit 8 prill 1975.
- H.Maslow, Abraham, *Drejt psikologjisë së qenies*, Shtëpia Botuese “Plejad”, Tiranë, 2008.
- Hado, Abaz, *Veshjet popullore dhe elemente të tjerë etnografike në pikturën shqiptare*, botuar në: “Kultura popullore”, nr. 1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturorë dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2011.
- Hamiti, Sabri, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta LXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 28, Prishtinë, 2005.
- Hamiti, Sabri, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta LXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 28, Prishtinë, 2005.
- Haxhiu, Fatmir, *Portreti në pikturë, në ekspozitën kombëtare të arteve figurative*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 7, Tiranë, 1975.
- Hoxha, Enver, *Për rininë*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1985.
- Hoxha, Enver, *Raporte e fjalime, 1972-1973*.
- Hoxha, Enver, *Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë*. Fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të Partisë më 20 dhjetor 1974, lidhur me zbatimin e deritanishëm të detyrave të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë për letërsinë dhe artet, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 2, Tiranë, 1975.
- Kallulli, Adriatik, *Historia e atdheut në krijimtarinë e një piktori*, në: “Studime për artin”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturorë dhe Studimeve të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2009.
- Kondo, Anastas, *Krijimtaria e talenteve të reja në fushën e letërsisë dhe artit dhe detyrat e zhvillimit të saj të mëtejshëm në dritën e orientimeve të plenumit IV të KQ të PPSH*. Nga raporti i shokut Anastas Kondo, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. 1, Tiranë, 1974.
- Le Bon, Gustav, *Psikologjia e popujve dhe e turmave*, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë, 2012.
- Meta, Beqir, Krasniqi, Afrim, Bello, Hasan, *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (Dokumente arkivore), 1969-1973*, vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Fondacioni Konrad Adenauer, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Tiranë, 2019.
- Qendro, Gëzim, *Gjuha Pamore*, Universiteti Polis, Botime Afrojdit, Tiranë, 2008.
- Qendro, Gëzim, *Proletariati ynë që rri mbi tokë*, në: “Studime për artin”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturorë dhe Studimeve të Artit, Departamenti i Arteve, Tiranë, 2009.
- Rama, Kristaq, *Pikturë e ndritshme, e bukur, shqiptare*, botuar në revistën: “Nëntori”, nr. nr. 6, qershor, Tiranë, 1975.
- Standish, M.J.Alex, *Roli i Enver Hoxhës në zhvillimin e miteve socialiste shqiptare*, në: “Roli i miteve në historinë e Shqipërisë”, botuar në revistën: “Përpjekja”, Viti VI, nr. 15-16, janar-dhjetor, Tiranë, 1999.

- Sula, Lili, *Fiksioni vs faktit në veprën Epika e yjeve të mëngjesit, të Rudi Erebarës*, botuar në: “Seminari XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2017.
- Velo, Maks, *Jetë paralele (Sipas raporteve të Sigurimit të Shtetit)-Dokumentet sekrete të ndjekjes, hetimit, dënimit dhe burgut*, UET/PRESS, Tiranë, 2018.